REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

**02 Nr.220 /24**
**Më: 14.11.2024**
**Mamushë**

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/l-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

# VENDIM

**Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.**

**I**

Menaxher i kontratës për projektin me titull: "FURNIZIMI ME KARBURANT PËR RAJONIN E PRIZRENIT (NIVELI LOKAL)" me numër të prokurimit: UA/2016-24-2858-1-1-1 dhe me nr. të brendshëm UA/2016-24-2858-1-1-1/C493 , emërohet z **FAHRI KRÜEZI,** ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet **Z. YAHYA SALA.**

**II**

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitët para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të menaxherit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik , menaxheri i kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

**III**

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

**Menaxheri i kontratës do të:**

a. menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
b. sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
c. bëj vlerësimin e përformancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

**Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:**

a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontrtës në sistem të prokurimit elektronik;
g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit te puneve, mallrave dhe sherbimeve
j. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimi; dhe
k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

**V**

**Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:**

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

**VI**

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/l-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanatë bëjnë me menaxhimin e kontratës.

**VII**

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- Drejtoria e Administratës,
- Zyra e Prokurimit,
- Pala,
- Arkivit.

**Abdülhadi Krasniç**
Kryetari i Komunës së Mamushës

______________________

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr 219 /24
Me 12.11.2024
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve 01 Nr. 007-19 të datës 28.03.2019, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës merrë këtë:

**V E N D I M**
**Pagesë subvencione për lehona**

**Neni 1**

Në bazë të Vendimi të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere 02 Nr.26-24 të datës 14.02.2024 dhe Rekomandimit të Komisionit 02Nr.73-24 të datës 11.11.2024 lejohen pagesat për kategorinë e subvencione dhe transfere sipas kërkesave të lehonave.

**Neni 2**

Mjetet që lejohen për pagesë, janë nga Kategoria e Subvencioneve dhe transferove sipas kërkesës së Lehonave.

Pagesa do të bëhet në shuma prej 800€

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Letërnjoftimi | Emri i Bankës | Xhirollogaria Bankare | Shuma € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Z[redacted] M[redacted] | 1[redacted]9 | BKT | 1[redacted]6 | 100.00 € |
| 2 | Ha[redacted] K[redacted] | 1[redacted]5 | TEB | 2[redacted]94 | 100.00 € |
| 3 | V[redacted] M[redacted] | 11[redacted]3 | TEB | 2[redacted]47 | 100.00 € |
| 4 | F[redacted]M[redacted] | 1[redacted]1 | BKT | 1[redacted]4 | 100.00 € |
| 5 | Me[redacted] M[redacted] | 1[redacted]8 | BPB | 1[redacted]1 | 100.00 € |
| 6 | T[redacted] K[redacted] | 1[redacted]1 | TEB | 2[redacted]51 | 100.00 € |
| 7 | G[redacted] M[redacted] | 1[redacted]1 | TEB | 2[redacted]7 | 100.00 € |
| 8 | N[redacted] Ma[redacted] | 1[redacted]8 | Banka Ekonomike | 1[redacted]74 | 100.00 € |

**Neni 3**

**Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.**

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF
- Thesari-MFPT
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

**Abdülhadi Krasniç**

Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 218-24
Tarih/Dt. 12.11.2024

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr. 218/24
Më:12.11.2024
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës Nr.001/2008 i datës 01.12.2008, Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndër komunal në Zonën Ekonomike "Jug" të datës 16 dhjetor 2008 dhe Termave të Referencës për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit Rajonal për Projekte Komunale (ERPK) Nr.27022020ERPK, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

1. Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.
2. Bazuar në Memorandumin me nr të protokolit 02-68-24 i datës 02.10.2024, obligohet AZHR-Jug që të fillojë të gjitha procedurat për funksionalizimit e ERPK sipas termarev të referencës të themelimit të funksionimit klësaj memorandumi.
3. Mjetet që lejohen për pagesë bllokut kodues, periudha e shpenzimit nëntor 2024:
   - 10/626/48014/130/00000/0411, shuma 7,600.00€
4. Obligohet AZHR-Jug të përpilojë raport detaj nga data 02.10.2024 deri më 25.12.2024.

5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtorisë Për Zhvillim Ekonomik;
2. AZHR-Jug;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

**Abdülhadi Krasniç**

Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No/Nr. 02 217-24
Tarih/Dt. 08.11.2024

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr. 217 -24
Me 08.11. -24
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

# V E N D I M

## Për caktimin e komisionit për pranimin teknik

**Formohet** komisioni për pranimin të punimeve në bazë të Kontratës Publike Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim i Objekteve Institucionale në Mamushë me numër të prokurimit 626-24-9270-2-2-1 dhe Numri i brendshëm 626-24-022-2-2-1.

**I.** Komisioni i lartë përmendur do të ketë këtë përbërje:

**Për Objekt të Administratës**

1. Afrim Mazrek
2. Nusret Morina
3. Seylan Alaybeg

**Për Objketet Shkollore**

1. Durak Mazrek
2. Nuhi Mazrek
3. Ferman Morina

**Për objekt të QKMF**

1. Mirat Morina
2. Fahridin Morina
3. Valbone Kastrati

**Për Shërbime Publike**

1. Rahman Morina
2. Ismail Mazrek
3. Ziaydin Kruezi

Anëtarët e Komisionit kanë për detyrë që gjatë dhe pas Dezinfektimit, Dezinsektim dhe Dertatizimin të objekteve Institucionale të Komunës së Mamushës, të hartojnë një raport mbi pranimit teknik të punës së kryer.

**Me këtë vendim të njoftohet:**

1. Anëtarët
2. Zyra e Prokurimit dhe
3. Arkiva

**Kryetar i Komunës**

**Abdülhadi Krasniç**

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazni - Outgoing
Nr. 02 216-24
08.11.2024

02 Nr. 216 -24
Me 08.11.2024
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 26 dhe 27 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët Publik, Memorandum Bashkëpunimi të nënshkruar nga RDA-AZHR JUG dhe Kryetari i Komunës së Mamushës si dhe lidhur me nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008 ,Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

# V E N D I M

***Për Caktimin e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin memorandumit***

**I**

z. Resit Mazrek me anë të këtij vendim **CAKTOHET** Zyrtar Përgjegjës për menaxhimin e Memorandumit 02-Nr.68-24 e datës 02.10.2024.

**II**

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit Zyrtar Përgjegjës për menaxhimin memorandumit, janë të përcaktuar sipas Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02Nr.68-24 e datës 02.10.2024.

**III**

Gjithashtu zyrtari përgjegjës është i obliguar konform Memorandumit të hartoj raport pas çdo pagese.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës .

**Me këtë vendim të njoftohet:**

1. Drejtoria e Zhvillimit Ekonimik
2. Z. Resit Mazrek
3. Drejtorit Komunale
4. Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

02 Nr. 215 -24
Me 08.11.2024
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 53 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët Publik, si dhe lidhur me nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008 ,Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

**ANULOHET Vendimi me numër të protokollit 02/Nr.186-24 e datës 07.10.2024**
***Për Caktimin e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin memorandumit***

**I**

z. Aziz Elshani me pozitë zyrtar i lartë për Buxhet dhe Financa, pranë Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik i caktuar zyrtarit përgjegjës për menaxhimin memorandumit 02-Nr.68-24 e datës 02.10.2024, me numër të protokollit 02/Nr.186-24 e datës 07.10.2024.

**II**

Me anët të këtij vendimi anulohet Vendimi me numër të protokollit 02/Nr.186-24 e datës 07.10.2024 Për Caktimin e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin memorandumit.

**III**

Ky vendim Hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

**Me këtë vendim të njoftohet:**

1. Drejtoria e Zhvillimit Ekonimik
2. Z. Aziz Elshani
3. Drejtorit Komunale
4. Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazće - Outgoing
02 No.Nr. 214-24
Tarih/Dt. 08.11.2024

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**MAMUŞA BELEDİYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA**

**Zyra e Kryetarit**
**02 Nr.214/24**
**Me 08.11.2024**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 nenit 44 dhe 45, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës NR.21/18 shtator 2023 , lidhur me nenin 22, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

**Vendim për Plotësim ndryshimi i vendimit 02/Nr.37/24**

***-Komisioni i pranimit për pozitat të kategorisë e Ulët Drejtuese-***

I. **Formohet:** Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil në pozitën e pranimit të kategorisë së ulët Drejtuese në Komunën e Mamushës
II. Komisioni i Pranimit në pajtim me neni I të këtij neni përbëhet nga:

1. Znj. Sihana Uka U.D Kryesuese Menaxhere e personelit
2. znj. Esra Osi - anëtare Shefe e Sektorit DPUGJK
3. Z.Çabej Nurkollar-anëtar-Përfaqësues Ligjor i Komunës-Avokat Komunal
4. Z. Skender Sala- anëtar- Udhëheqës i Sektorit në Administratën e Përgjithshme
5. Z.Nazmi Morina – Anëtar- i Komisionit

Komisioni i pranimit si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil.

**ARSYETIM**

Ndryshohet përbërja Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil në pozitën të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës, me këtë vendim ndryshohet neni 2 pika 1 ku sipas vendimit 02/Nr.037/24 e datës 12.03.2024, në pozitën e Kryesueses së Komisionit ka qenë znj. Shefkije Morina e cila ka qenë e caktuar si U.D Menaxhere e Personelit, ku pas përfundimit të procedurave të konkursit në pozitën e

Menaxherit të Personelit, në këtë pozitë është znj. Sihana Uka e cila bazuar në nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik, Menaxheri i Personelit është edhe Kryesuese e Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil.

**Kryetar i Komunës së Mamushës**
**Abdülhadi KRASNIÇ**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 213-24
Tarih/Dt. 08.11.2024

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**MAMUŞA BELEDİYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA**

**Zyra e Kryetarit**
**02 Nr. 213/24**
**Me 08.11 2024**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës NR.21/18 shtator 2023 , lidhur me nenin 20, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

# V E N D I M

***Komisioni i pranimit për pozitat të kategorisë profesionale***

## Neni I

**Formohet:** Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil në pozitën të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës.

## Neni II

Komisioni i Pranimit në pajtim me neni I të këtij neni përbëhet nga:

1. Znj. Sihana Uka- Kryesuese Menaxhere e personelit
2. znj. Esra Osi - anëtare Shefe e Sektorit DPUGJK
3. Z. Skender Sala- anëtar- Udhëheqës i Sektorit në Administratën e Përgjithshme
4. Z.Çabej Nurkollar-anëtar-Përfaqësues Ligjor i Komunës-Avokat Komunal
5. Z.Nazmi Morina – anëtar- i Komisionit.

## Neni III

Komisioni i pranimit si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës.

## Neni IV

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil.

**Neni V**

Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi me numër të Proktollit 02/Nr.37/24 e datës 12.03.2024

**A R S Y E T I M**

Ndryshohet përbërja Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil në pozitën të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës, me këtë vendim ndryshohet neni 2 pika 1 ku sipas vendimit 02/Nr.037/24 e datës 12.03.2024, në pozitën e Kryesueses së Komisionit ka qenë znj. Shefkije Morina e cila ka qenë e caktuar si U.D Menaxhere e Personelit, ku pas përfundimit të procedurave të konkursit në pozitën e Menaxherit të Personelit, në këtë pozitë është znj. Sihana Uka e cila bazuar në nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik, Menaxheri i Personelit është edhe Kryesuese e Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil.

**Kryetar i Komunës së Mamushës**
**Abdülhadi KRASNIÇ**

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 212 /24
Me 08.11.2024
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

# V E N D I M

***Për pagesën e Sigurimit dhe TPL+ për auto përgjegjësisë të mjeteve motorike***

## Neni 1

Lejohet pagesa për Eurosig Kompani Sigurimesh me nr të faturës 063597, dhe 063602 të datës 05.11.2024 për sigurimin e automjetit Pegueot 308 me numër të shasisë VR3FBZHZ1RY605938 me ngjyrë të zezë.

## Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria Mallra dhe Shërbime sipas përshkrimit, 10/626/85014/13951/00000/0820, dhe me numër të zotimit 2024-228411 dhe 2024-228399.

| Perfituesi | NR.UNIK | Xhirrollogaria | Shuma |
|---|---|---|---|
| Eurosig | 811296054 | 1901397121031164 | 137.47 € |
| Eurosig | 811296054 | 1901397121031164 | 41.24 € |

## Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria Përkatëse.
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

**Abdülhadi Krasniç**

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No/Nr. 211-24
Tarih/Dt. ...11.2024

02 Nr. 211-24
Me 08.11.-24
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregulloreve të Prokurimit Publik si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

# V E N D I M

## Për caktimin e komisionit për pranim teknik

**1.Caktohet** komisioni për pranim teknik të punëve të kryera dhe punët shtesë në projektin ***"FURNIZIM ME MATERIALE SHPENZUESE PËR ZYRE TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATËN E AQP"*** – me nr. Identifikues 626-24-6472-1-3-6 dhe nr. të brendshëm 326-24-016-1-3-6.

**Komisioni do të jetë në këtë përbërje:**

1.1.Eroll Morina– Kryetar i komisionit
1.2.Faruk Taç – Anëtar
1.3.Nuhi Mazrek – Anëtar

**2.** Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin teknik të punëve të kryera dhe punët shtesë sipas, para masës dhe para llogarisë në projektin ***"FURNIZIM MATERIALE SHPENZUESE PËR ZYRE TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATËN E AQP".***

**3.** Obligohet komisioni që këto punë t`i kryejë duke u bazuar në kontratën me nr. Identifikues 626-24-6472-1-3-6 dhe nr. të brendshëm 326-24-016-1-3-6. .

**4.**Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe të bëj pranimin e furnizimit sipas njësisë kërkuese

**5.** Komisioni duhet të hartoj një raport menaxherin e kontratës.

**6.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit , menaxheri i kontratës

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

**Me këtë vendim të njoftohet:**

1. Drejtoria përkatëse
2. Zyra e Prokurimit dhe
3. Arkiva

**Kryetari i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi Krasniç**

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 210-24
Tarih/D 07.11.2024

**ZYRA E KRYETARIT**
**02- Nr- 0210/24**
Me datë: **07.11.2024**

Duke u bazuar në neni 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 82 të Statutit të Komunës së Mamushës 001/2008 e datës 01.12.2008, si dhe në mbështetje të nenit 4 paragrafi 4 neni 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 të Rregullores 01/Nr.007-19 e datës 28.03.2019 për Kushte, Kritere dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, kërkesës së palës me nr. protokollit 02.Nr.72/24 e datës 25.10.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

**I**

**MIRATOHET-** kërkesa e Hadije Kryezi me numër personal 1003210312 me numër të protokollit 02/Nr.72/24 e datës 25.10.2024 , për ndihmë financiare prej 553.85€, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman.

**II**

Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**IV**

Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Hadije Kryezi me numër personal 1003210312 vuan nga sëmundja e rëndë, Kardio Vaskulare, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për sëmundjen nga e cila vuan. Tretmantet e sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është nuk është në marrëdhënie të pune të vazhdueshëm, si dhe bashkëshorti i saj ka ndëruar jetë.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të lartpërmendurës, pasi që shpenzimet për tretman mjekësor dhe të blerjes së barërave për trajtimin e sëmundjes kanë kosto të lartë financiare, pasi që e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barërave për trajtimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:
Hadije Kryezi
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Arkiva

**Kryetari i Komunës**

**Abdulhadi Krasniç**

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŞA BELEDİYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlaz - Outgoing
02 No.Nr. 2039A-24
Tarih/Dt. 01.11.2024

**Zyra e Kryetarit**
**02 Nr.2039A/24**
**Me 01.11.2024**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Marrëveshjes të nënshkruar në mes të Komunës së Mamushës dhe RDA-JUG me numër të protokollit 02.Nr,68/24 e datës 02.10.2024, Marrëveshja për bashkëpunim ndër komunal në zonën ekonomike jug të datës 16 dhjetor 2016 dhe termave të referencës për themelimin dhe funksionimin e ekipit rajonal për projekte Komunale (ERPK) NR.27022020 ERPK, Kontratës së Punës të lidhur në mes të Agjencia për Zhvillim Rajonal dhe Sakir Mazrek, Kërkesës së SH.F.M.U ANADOLU me numër të Protokollit 97/24, drejtuar DKA-së, si dhe Kërkesës së Drejtorit të DKA-së me numër të Protokollit 02.Nr.72A-2024 e datës 01.11.2024 Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

## VENDIM

**I.** z. Sakir Mazreku me numër personal 1173602754, caktohet, mësimdhënës në Shkollën Fillore ANADOLU si mësimdhënës i lëndën e Edukatës Qytetare.

**II.** I caktuari si në pikën I të këtij vendim do ti kryej përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për Arsim paraunviersitar, dhe Aktet e brendshme.

**III.** Ky vendim Hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të këtij vendimi dhe do të zgjas për aq sa është përcaktuar në kontratën bazë, përveç nëse palët merren vesh ndryshe.

## ARSYETIM

z. Sakir Mazreku me numër personal 1173602754, ka nënshkruar kontratë pune në kohë të caktuar me Agjencia për Zhvillim Rajonal-Jug, në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar në mes të Komunës së Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal-Jug, me numër të protokollit 02.Nr,68/24 e datës 02.10.2024 si dhe bazuar në konkursin e hapur nga Agjencia për Zhvillim Rajonal-Jug.

Kontrata e punës e lidhur në mes të palëve me të cilin Z. Sakir Mazrek është caktuar në vendin e punës me pozitë të Koordinatorit për Sport dhe se në nenin 2 të Kontratës së Punës, janë përcaktuar detyrat e punës.

Duke marrë parasysh mungesën e Mësimdhënësve në Shkollën Fillore ANADOLU marrë për bazë edhe kërkesën e parashtruar nga Drejtori i Shkollës, sidomos në lëndën për të cilin është caktuar me këtë vendim, dhe pamundësinë e hapjes së Konkurseve publike, z. Sakir Mazreku paralelisht me punën e Koordinatorit për kulturë caktohet edhe si mësimdhënës i përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

Andaj, është vendosur si në Dispozitivin e këtij vendimi.

**Kryetar i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi KRASNIÇ**

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 209 - 24
04.11.2024

02.Nr.209 /2024

Me_04.11.2024 Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës ,të dates 01.12.2008 Kryetarui I Komunës së Mamushës bie këtë:

# VENDIM

**Pagesë e Kujdestarisë QKMF - Mamushë**

**Neni . 1**

**Aprovohet** kërkesa e Qendrës së Mjeksësisë Familjare-Mamushë për pagesën e kujdestarisë, per muajin **Tetor/2024,**

**Neni . 2**

Mjetet që lejohen për pagesë janë te dedikuara për periudhen **01.10.2024 deri 31.10.2024, ne** shumën prej **2.229,34€ nga programi Sherbimet e Shëndetesisë Primare, kodi 73850** nga kategoria paga dhe mëditje.

**Neni . 3**

**Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.**

Me këtëvendim të njoftohet :

1. Drejtoria e Shëndetesisë dhe Mirqenje Sociale
2. Departamenti i pagave-Thesar
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

---------------------------------------------

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 208A-24
Tarih/Dt. 01.11.2024

**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**MAMUŞA BELEDİYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA**

**Zyra e Kryetarit**
**02 Nr.208A/24**
**Me 01.11.2024**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Marrëveshjes të nënshkruar në mes të Komunës së Mamushës dhe RDA-JUG me numër të protokollit 02.Nr,68/24 e datës 02.10.2024, Marrëveshja për bashkëpunim ndër komunal në zonën ekonomike jug të datës 16 dhjetor 2016 dhe termave të referencës për themelimin dhe funksionimin e ekipit rajonal për projekte Komunale (ERPK) NR.27022020 ERPK, Kontratës së Punës të lidhur në mes të Agjencia për Zhvillim Rajonal dhe Kenan Morina, Kërkesës së SH.M.L ATATURK me numër të Protokollit 24/24, drejtuar DKA-së, si dhe Kërkesës së Drejtorit të DKA-së me numër të Protokollit 02.Nr.72A-2024 e datës 01.11.2024 Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

## VENDIM

**I.** z. Kenan Morina me numër personal 1173602789, caktohet, mësimdhënës në Shkollën e Mesme ATATURK si mësimdhënës i lëndëve Zgjedhore dhe edukatën fizike.

**II.** I caktuari si në pikën I të këtij vendim do ti kryej përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për Arsim paraunviersitar, dhe Aktet e brendshme.

**III.** Ky vendim Hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të këtij vendimi dhe do të zgjas për aq sa është përcaktuar në kontratën bazë, përveç nëse palët merren vesh ndryshe.

## ARSYETIM

z. Kenan Morina me numër personal 1173602789, ka nënshkruar kontratë pune në kohë të caktuar me Agjencia për Zhvillim Rajonal-Jug, në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar në mes të Komunës së Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal-Jug, me numër të protokollit 02.Nr,68/24 e datës 02.10.2024 si dhe bazuar në konkursin e hapur nga Agjencia për Zhvillim Rajonal-Jug.

Kontrata e punës e lidhur në mes të palëve me të cilin Z. Kenan Morina është caktuar në vendin e punës me pozitë të Koordinatorit për Kulturë dhe se në nenin 2 të Kontratës së Punës, janë përcaktuar detyrat e punës.

Duke marrë parasysh mungesën e Mësimdhënësve në Shkollën e Mesme ATATURK marrë për bazë edhe kërkesën e parashtruar nga Drejtori i Shkollës, e sidomos në lëndën për të cilin është caktuar me këtë vendim, dhe pamundësinë e hapjes së Konkurseve publike, Kenan Morina paralelisht me punën e Koordinatorit për kulturë caktohet edhe si mësimdhënës i përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

Andaj, është vendosur si në Dispozitivin e këtij vendimi.

**Kryetar i Komunës së Mamushës**

**Abdülhadi KRASNIÇ**